



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality of Rahovec



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport / Odeljenje za Kulturę, Omladinu i Sport

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAČ
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr i prot 1301 Me 10.04.20
Br prot 20 Dt 10.04.20
RAHOVEC ORAHOVAČ






Tabela e përmbajtjes

Sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.....	3
Aktivitetet.....	4
Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi".....	4
Palestra e sportit dhe aktivitetet sportive.....	5
Aktivitete tjera.....	5

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për gjatë tremujorit të parë, ka përfunduar aktivitete të planifikuara në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve, duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore, sportive e rinore të Komunës së Rahovecit.

- Në raport të punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.
- Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.
- Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe.

Cfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në mars të vitit 2020. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.

Aktivitetet e DKRS-së për periudhën raportuese të tre mujorit të parë të 2020 janë:

Në tre muajt e parë të vitit 2020, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, janë realizuar shumë takime me partner dhe palë të jashtme, ku jemi përkushtuar maksimalisht në arritjen e objektivave në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbushur planin e punës, qëllimet dhe arritjen e objektivave në këtë periudhë kohore.

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2020,
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga DKRS-së nga viti paraprak,
- Përgatitja e planit të prokurimit për projekte kapitale.

Për nder të manifestimit tradicional, kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit”, është formuar Këshilli Organizues, nga i cili janë planifikuar organizimi i këtyre aktiviteteve:

- Shpallja e Konkursit Letrar “Pena e Flakës së Janarit”.
- Homazhe dhe nderime për dëshmorët e kombit (Fortesë, Brestoc, Ratkoc),
- Ekspozitë në Galerinë e arteve, në bashkëpunim me OJQ Art Studio,
- Manifestimi qendror përkujtimor e kulturor “Flaka e Janarit” në Qendrën e Kulturore “Mensur Zyberaj” në Rahovec, si dhe promovimi i monografisë për dëshmorin Nesimi Elshani, nga autori Qemajl Krasniqi.

Përgatitja e specifikacionit të thirrjes publike për subvencionimin e OJV-ve.

Përgatitja e specifikacionit të tenderit "Furnizim me flamuj, kurora, buqeta lulesh për aktivitete përkujtimore".

Tenderi "Furnizim i bibliotekës me libra", është në proces edhe gjatë vitit 2020.

Vazhdimi i punimeve, në kuadër të projektit "Restaurimi i monumenteve kulturore – historike" të projekteve rreth trashëgimisë kulturore, kujdesi për objektet në listën e mbrojtës së trashëgimisë kulturore dhe caktimi në list të atyre që duhet të ruhen, evidentimi dhe përkufizimi i vlerave kulturore e historike të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Është mbajtur Ceremonia e shpalljes së Sportistit më të mirë për vitin 2019.

Për nder të 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, janë organizuar një varg manifestimesh kulturore-artistike dhe sportive:

- Formimi i Këshillit Organizues për nder të Ditës së Republikës së Kosovës, 17 shkurt.
- Shpallja e njoftimit për regjistrimin e ekipeve, për garat e organizuara për nder të 17 Shkurtit.
- Organizimi i garave sportive me fëmijët e Shkollave të Futbollit që veprojnë në Komunën e Rahovecit (gara janë zhvilluar mes fëmijëve të lindur në ditën e shpalljes së pavarësisë).
- Tryezë diskutimi me Historianë, tema "Arsimi shqip në Kosovë gjatë viteve të 90-të".
- Javë sportive në futboll të vogël, homazhe në të gjitha vendlëqet, seancë solemne si dhe programi qendror festiv (Qendra e Kulturës "Mensur Zyberaj", Rahovec)

Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi"

- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit

Gjatë kësaj periudhe, kemi bashkëpunuar me dashamirë të librit: mësime, nxënës, shkrimtarë të komunës sonë, në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijës rreth lexueshmërisë.

Kemi aplikuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për furnizim të bibliotekës me libra.

Poashtu, kemi bashkëpunim të mirë me Bibliotekën Kombëtare, Bibliotekën Universitare, Bibliotekën Regjionale "Ibrahim Rugova"- Gjakovë, Bibliotekën "Hivzi Sylejmani"- Prishtinë, B. e Prizrenit etj.

Falë bashkëpunimit të mirë që kemi krijuar me institucione kulturore, biblioteka jonë është pasuruar me tituj të rinjë librash.

Pasurimi i fondit librar: 531 ekzemplar Janar-Mars

Fondi total i librave në bibliotekë: 17675 ekzemplar.

Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar: 122 përdorues.

- 1.1 Antarësimi në bibliotekë për muajin Janar - Mars

Periudha	Anëtar	Me pagesë	Gratis	Libra të lexuar	Djem	Vajza
Janar-Mars	285	280	5	1651	622	1029

Tabela e lexuesve për muajin Janar - Mars

Sh.Fillore	Sh.Mesme	Student	Të tjerë	Djem	Vajza	Gjithësej
214	45	11	10	103	182	285

Palestra e sportit "Mizahir Isma" dhe aktivitete të tjera sportive

Gjatë tre mujorit të parë, në palestër janë realizuar aktivitete të shumta sportive, si nga klube të Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ata ndërkombëtare, ndër aktivitete tjera janë:

- Kombëtarja e Kosovës ka zhvilluar dy ndeshje në Hendboll me Kombëtarën e Kuwaitit "Kosova vs Kuwaiti".
- Ndeshjet e Superligës 2020, janë zhvilluar në Palestrën "Mizahir Isma".
- Kupa e Kosovës në Basketboll, organizim nga KB Rahoveci, në bashkëpunim me Federatën e Basketbollit dhe ofrimi i të gjitha kapaciteteve të nevojshme nga Komuna e Rahovecit.
- Përpos këtyre ndeshjeve, janë zhvilluar ndeshje nga klube tjera të Komunës së Rahovecit, si dhe aktivitete tjera të përditshme, të cilat mbahen në palestër.

Duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e shumta për sigurim të transportit për klube sportive, për zhvillimin e aktiviteteve të tyre në përgjithësi, si DKRS shumicën e kërkesave i kemi aprovuar, duke ju siguruar mjete transportuese, që janë në pajtim me politikat programore të drejtorisë.

Poashtu, ka vazhduar mirëmbajtja e palestrës, në kuadër të kontratës për "Mirëmbajtjen dhe pastrimin e Palestrës Sportive "Mizahir Isma".


Ps: Nga data 16.03.2020 janë ndërprerë të gjitha aktivitetet në palestër, për shkak të pandemisë COVID-19.

Përveç këtyre punëve të realizuara për periudhën tre mujore, janë realizuar edhe aktivitete e punë të përditshme, si:

- Pranimi dhe shqyrtimi i lëndëve të ndryshme,
- Vizitë objekteve sportive e kulturore,
- Takime me të rinjë, klube sportive e kulturore,
- Monitorimi i aktiviteteve të subvencionuara nga DKRS-së.

Rahovec, 2020

Drejtoreshë e DKRS-së


Bjondina Kleqka